

Mbroni fëmijën tuaj me vaksinat

Vaksinat falas të fëmijës suaj e mbrojnë atë nga sëmundjet infektive, në çdo ditë.

Pse duhet ta vaksinoj fëmijën tim?

Vaksinat e fëmijërisë u janë dhënë fëmijëve në Irlandë dhe në mbarë botën për shumë vite. Kërkimet na tregojnë se ato janë të sigurta dhe se funksionojnë.

Vaksinat janë mënyra më e mirë dhe më e sigurt për të mbrojtur fëmijët tanë nga infektimet e rënda.



A ka rëndësi koha?

Mënyra më e mirë për ta mbajtur fëmijën tuaj të sigurt nga këto sëmundje është të siguroheni që ai t'i marrë të gjitha vaksinat në kohë.


Rruga më e mirë është të ecni sipas kalendarit, sepse çdo herë që një vaksinë bëhet me vonesë, vonesa e vendos në rrezik fëmijën.



A do ta mbrojnë vaksinat fëmijën tim nga sëmundjet?

Vaksinat e mbrojnë fëmijën tuaj nga 14 sëmundje infektive. Këto sëmundje nuk janë zhdukur.

Foshnjat dhe fëmijët e vegjël janë në rrezik më të lartë të sëmuren rëndë nga infeksionet, sepse sistemi imunitar i tyre nuk është zhvilluar ende plotësisht.



Sa kushtojnë vaksinat?

Në Irlandë, vaksinat e fëmijërisë janë falas për të gjithë fëmijët nëpërmjet mjekut të përgjithshëm të tyre.

Duke e vaksinuar fëmijën tuaj në kohë, ju i jepni atij mbrojtjen më të mirë në momentin që atij i nevojitet më shumë.



Çfarë ndodh nëse humbas një vizitë?

Nëse fëmija juaj ka humbur ndonjë vaksinë, ai mund ta plotësojë sërish atë. Bisedoni me mjekun tuaj të përgjithshëm ose me infermieren tuaj. Ata do të organizojnë që fëmija juaj të plotësohet me vaksinat që i nevojiten.

Nëse fëmija juaj ka ardhur në Irlandë nga një vend tjetër, ai mund të plotësojë gjithashtu vaksinat që rekomandohen në Irlandë.



Mos harroni pesë vizitat te mjeku juaj i përgjithshëm

Për më shumë informacion vizitoni
www.immunisation.ie



Vaksinat e fëmijës suaj

Foshnjat e lindura më ose pas 1 tetorit 2024

Cilat vakcina do të marrë fëmija im?

Vizita 1 – 2 muajsh

6 në 1+PCV+MenB+Rotavirus
3 injeksione + pika nga goja



Vizita 2 – 4 muajsh

6 në 1+MenB+Rotavirus
2 injeksione + pika nga goja



Vizita 3 – 6 muajsh

6 në 1+PCV
2 injeksione

Nuk bëhet më vaksinë Rotavirus në 8 muajsh 0 ditë ose më pas



Vizita 4 – 12 muajsh

MMR+MenB+Varicela
3 injeksione



Vizita 5 – 13 muajsh

6 në 1+MenC+PCV
3 injeksione



Nëse zhvendoseni në Irlandë

Nëse fëmija juaj ka ardhur në Irlandë nga një vend tjetër, ai duhet të marrë vaksinat që rekomandohen në Irlandë. Kjo gjë e mbron atë nga sëmundjet që janë më të zakonshme në Irlandë. Mjeku i përgjithshëm ose infermiera e klinikës do t'ju tregojë se cilat vakcina mund të dojë fëmijë juaj.

Shkurtesat dhe kuptimi i tyre

6 në 1 Difteria, Haemophilus influenzae b (Hib), Hepatiti B, Pertusis (kolla e mirë), Poliomyeliti dhe Tetanozi

PCV Pneumokokale konjugate

Rotavirus Vakcina orale e rotavirusit

MenB Meningokoku B

MMR Fruthi, Shytat, Rubeola

Lija e dhenve (Varicela) Vakcina kundër lisë së dhenve

MenC Meningokoku C



Çfarë mund të pres pasi fëmija im të marrë vaksinat?

- Temperatura është e zakonshme pas një vaksine MenB. Merrni me vete paracetamol të lëngshëm për foshnjat në dy vizitat tuaja të para. Kjo do të ndihmojë me temperaturën.
- Ndonjëherë fëmijët mund të kenë dhimbje, ënjtje dhe skuqje në zonën ku është bërë injeksioni. Sigurohuni që rrobat të mos jenë shumë të ngushta.
- Diarreja e lehtë është normale pas vaksinës oral të rotavirusit. Jepini fëmijës tuaj shumë qumësht. Lani duart me kujdes pasi të keni ndërruar dhe hedhur pelenën e fëmijës suaj.

Mbajtja në krahë dhe ushqyerja do të ndihmojnë që fëmija të ndihet më mirë pas vaksinave.

Mos harroni se fëmija juaj ka nevojë për pesë vizita te mjeku i përgjithshëm për t'u siguruar që ai është plotësisht i mbrojtur.

Informacione të tjera
[Vizitoni immunisation.ie](http://Vizitoni.immunisation.ie)

